



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1040 Prot.

Tiranë, më 20.9 2013

Lënda: 4 Rekomandim për "Studio Ligjore Pengili", Tiranë

REKOMANDIM

Nr. 22, datë 20/09/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit,

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Studio Ligjore Pengili" Tiranë me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale (nenet 5-9)
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe kofidencialiteti (nenet 27,28).
- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni 21)

Nga kontrollit administrativ u konstatua se:

Kontrolluesi "Studio Ligjore Pengili" ofron shërbime ligjore private ndaj klientëve të saj në zbatim të Ligjit Nr.9109, datë 17.7.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kontrolluesi "Studio Ligjore Pengili" jep ndihmë juridike për çështje të ndryshme. Të dhënat personale që mledh, përpunon për klientët janë në varësi të natyrës së kërkesës së klientit dhe në lidhje me çështjen që shtrohet për zgjidhje nga klienti.

Për sa i përket proporcionalitetit të mbledhjes, përpunimit të të dhënave personale kontrolluesi përpunon të dhëna si :

- Fotokopje e kartës së identitetit
- Adresa
- Dëshmi penaliteti (në varësi të çështjes që shtrohet për zgjidhje)
- Raporte mjekësore (në varësi të çështjes që shtrohet për zgjidhje) etj.

Këto të dhëna mblidhen në përputhje e zbatim të Ligjit Nr.9109, datë 17.7.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ky përpunim nga ana e kontrolluesit është i mjaftueshëm dhe lidhet me qëllimin për të cilin këto të dhëna

përpunohen, në përputhje edhe me nenin 5 pika c) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Në lidhje me kofidencialitetin e përpunimit të të dhënave personale të klientëve u konstatua se zbaton dhe funksionon në përputhje me nenin 9 pika 3) e Ligjit Nr.9109, datë 17.7.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku citohet shprehimisht se: "Avokatit i ndalohet të bëjë publike të dhënat, që i ka mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij ose nga dokumentet që ky i fundit i ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar, me përjashtim të rastit kur ai ka dhënë miratimin e tij me shkrim".

U konstatua se dosjet fizike të klientëve kontrolluesi i mban në mënyrë manuale për sa kohë ato janë në proces. Për sa i përket informimit të klientit për qëllimin e përpunimit të të dhënave të tyre, kategoritë e të dhënave si dhe përhapjen, kontrolluesi nuk dispononte një akt të qartë për subjektet "klient" në lidhje me detyrimin për informim në mënyrë të shprehur për këtë përpunimin, gjë e cila duhet të realizohet me anë të një akti informimi nga vetë kontrolluesi në përputhje me kriteret e nenit 18 pika 1).

"kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do të përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të kësaj informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij".

Gjithashtu u konstatua nga grupi i kontrollit se nuk ka një rregullore të brendshme ku te jetë parashikuar mënyra e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale për kategorinë "klientë" në zbatim të nenit 27 pika 2/1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ku citohet shprehimisht se: "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera"

Siguria e të dhënave

Gjatë inspektimit administrativ u konstatua se avokatja znj. Pengili ka marrë masa të përshtatshme tekniko - organizative për sigurinë e të dhënave për të cilat ky kontrollues administron. Konstatohet se në ushtrimin e veprimtarisë, kontrolluesi menaxhon dokumentacionin e klientëve të cilët kategorizohen në "persona fizik" dhe "persona juridik". Dokumentacioni përpunohet në kompjuter dhe si aksesori ndihmës konstatohet një pajisje printer/skaner. Konstatohet se kompjuteri është i aksesueshëm nëpërmjet "emrit të përdoruesit" dhe "fjalëkalimit" përkatës. Konstatohet gjithashtu se kompjuteri ka sistem antivirus. Kopje të dokumentacionit ruhet edhe në dosje për ç'do klient. Dosjet ruhen në ambient dollapë me çelës për të kufizuar aksesin fizik të tyre nga persona të paautorizuar. Konstatohet se kontrolluesi ka marrë masa për sigurinë fizike të ambienteve duke siguruar hyrjen e zyrës me qepena metalikë si dhe sistem alarmi anti-vjedhje e cila sinjalizon policinë në rast se tentohet të hapet me forcë dera e zyrës.

Gabimet njerëzore janë të pranishme gjatë hartimit të një dokumenti në kompjuter dhe mund të konstatohen nga palët e interesuara përballë avokates mbasi dokumenti është printuar. Për pasojë është i nevojshëm shkatërrimi i dokumentit jo të saktë dhe riformulimi i tij në mënyrë korrekte. Gjatë inspektimit administrativ u konstatua se dokumentacioni në formatin "letër", eliminohet duke u grisur dhe hedhur në koshin e mbeturinave. Dokumentacioni në formatin "letër" i cili griset dy, tre apo katër herë mund të jetë lehtësisht i rigjenerueshëm dhe për arsye informacioni në këto dokumenta të hedhura mund të aksesohet nga persona jo të

autorizuar. Është tepër i nevojshëm përdorimi i grirësës së letrës e cila realizon shkatërrimin e plotë dhe të parikuperueshëm të dokumentacionit në forëm letre.

U konstatua se pas kontrollit administrativ kontrolluesi "Studio Ligjore Pengili" kreu detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Komisionerit duke e plotësuar Formularin e Njoftimit.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- 1) Kontrolluesi nuk informon në mënyrë të qartë me anë të një akti subjektet e të dhënave "klientë" për qëllimin apo qëllimet e përpunimit, për mënyrën sesi do të përpunohen të dhënat në zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- 2) Kontrolluesi "Studio Ligjore Pengili" nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave personale të klientëve, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Të informohen në mënyrë të qartë, të plotë dhe të shprehur me anë të një akti subjektet e të dhënave "klientë" për qëllimin/met e përpunimit, për kategorinë e të dhënave që mbledhen dhe përpunohen, për personin apo personat që do ti përpunojnë të dhënat, për mënyrën sesi do të përpunohen të dhënat dhe të drejtat e subjektit për të patur akses apo për ti korigjuar ato, bazuar dhe në zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale";
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, shkatërrimin, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale të klientëve. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
3. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e

denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

